

LETËR E HAPUR

KËRKESË PËR TRANSPARENCË DHE NDËRHJRJE PËR ULJEN E ÇMIMIT TË NAFTËS NË SHQIPËRI

Letër e Hapur Drejtuar Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Autoritetit të Konkurrencës, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe institucioneve përgjegjëse



Kërkesë për transparencë dhe ndërhyrje për uljen e çmimit të naftës në Shqipëri

Të nderuar përfaqësues të institucioneve shtetërore,

Në emër të Diasporës së Bashkuar Shqiptare (UDA), shprehim shqetësimin e thellë të qytetarëve, sipërmarrësve dhe profesionistëve shqiptarë lidhur me çmimet e larta të karburanteve në Shqipëri, të cilat vazhdojnë të ndikojnë negativisht në koston e jetesës, aktivitetin ekonomik dhe fuqinë konkurruese të vendit.

Është e pakuptueshme që, në një kohë kur çmimet e naftës bruto në tregjet botërore kanë njohur ulje të ndjeshme, qytetarët shqiptarë vazhdojnë të përballen me kosto karburanti dukshëm më të larta se vendet fqinje. Ky disproportion bëhet edhe më evident nga fakti se rritjet e çmimeve reflektohen menjëherë në pikat e shitjes, ndërsa uljet vonohen ose zhduken përgjatë zinxhirit të furnizimit, duke mos arritur në masën e duhur te konsumatori final.

Të dhënat e publikuara nga ekspertë dhe institucione të pavarura tregojnë se çmimi i lartë i naftës në Shqipëri nuk është vetëm pasojë e zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare, por edhe e peshës së lartë të taksave dhe tarifave vendase. Aktualisht, rreth gjysma ose më shumë e çmimit që paguhet në pompë përbëhet nga detyrime fiskale, duke e bërë karburantin një barrë gjithnjë e më të rëndë për qytetarët dhe bizneset shqiptare.

Një shqetësim i veçantë mbetet taksa e qarkullimit, e cila vazhdon të rëndojë konsumatorët shqiptarë. Vetëm gjatë vitit 2025, nga kjo taksë u mbledhën rreth 220 milionë euro, ndërsa mungesa e transparencës mbi përdorimin e këtyre fondeve vazhdon të ngrejë pikëpyetje te qytetarët. Një tjetër shqetësim lidhet me funksionimin e tregut të karburanteve dhe nivelin e konkurrencës në të. Mbetet e paqartë pse Shqipëria vijon të ketë çmime më të larta se Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina, pavarësisht se furnizohet nga të njëjtat tregje ndërkombëtare.

Sipas analizave krahasuese, Shqipëria renditet ndër vendet me barrën më të lartë të koston së karburanteve në raport me të ardhurat e qytetarëve. Një qytetar shqiptar shpenzon një përqindje dukshëm më të lartë të të ardhurave të tij për të blerë një litër naftë sesa qytetarët e vendeve fqinje apo të Bashkimit Evropian.

Çmimi i lartë i naftës nuk prek vetëm drejtuesit e automjeteve. Ai rrit koston e transportit, shtrenjon produktet dhe shërbimet, rëndon bizneset dhe ul mirëqenien e familjeve shqiptare.

Për këtë arsye, kërkojmë nga institucionet kompetente:

- Transparencë të plotë mbi strukturën e çmimit të karburanteve dhe peshën e taksave në çmimin final.
- Hetim dhe analizë të pavarur mbi konkurrencën në tregun e karburanteve.
- Rishikimin e barrës fiskale mbi karburantet, veçanërisht kur çmimet ndërkombëtare janë në rënie.
- Reflektimin e shpejtë dhe proporcional të uljeve të çmimeve ndërkombëtare në tregun shqiptar.
- Transparencë mbi përdorimin e të ardhurave të mbledhura nga taksat e karburanteve.

Qytetarët shqiptarë nuk mund të vazhdojnë të përballen me çmimet më të larta të karburanteve në rajon, ndërkohë që të ardhurat e tyre mbeten ndër më të ulëtat në Evropë. Kërkojmë transparencë, llogaridhënie dhe masa konkrete që sigurojnë një treg të drejtë, konkurrencë reale dhe çmime të përballueshme për çdo qytetar shqiptar.